



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.201/4, Datë 11.06.2020

PËR
MOSPËRFSHIRJEN E Z. {...} NË LISTËN E KANDIDATËVE PËR NGRITJEN NË
DETYRË NË GJYKATËN E LARTË, PËR POZICIONET E LIRA
TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 84, NR. 86 DHE NR. 87, DATË 26.02.2020,
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 11.06.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe shqyrtoi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës “Për mospërfshirjen e aplikuesit z. {...} në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 84, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tre pozicione të lira të shpallura në të njëjtën kohë”, si dhe relacionin përkatës për këtë propozim,

VËREN:

I. PROCEDURAT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË GJYKATËN E LARTË

1. Me Vendimin nr. 82, datë 26.02.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative”.

2. Me Vendimin nr. 85, datë 26.02.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

3. Për të dyja procedurat e ngritjes në detyrë sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, afati i kandidimit është përcaktuar “dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

4. Me Vendimin nr. 83, datë 26.02.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative”.

5. Me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

6. Për të dyja procedurat e ngritjes në detyrë sipas pikave 4 dhe 5 të këtij vendimi, afati i kandidimit është përcaktuar “dy muaj nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

7. Me Vendimin nr. 84, datë 26.02.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative”.

8. Me Vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

9. Për të dyja procedurat e ngritjes në detyrë sipas pikave 7 dhe 8 të këtij vendimi, afati i kandidimit është përcaktuar “pesë muaj nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

10. Vendimet e Këshillit si më lart për hapjen e procedurave të kandidimit për në Gjykatën e Lartë, janë publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 28.02.2020, përfshirë dhe një njoftim publik për hapjen e secilës prej këtyre procedurave. Në këto Njoftime Publike, krahas të tjerash, të interesuarve u është kërkuar të kenë në vëmendje kërkesat e pikës 6, të nenit 48, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), sipas të cilit: “*Pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë, kandidati mund të kandidojë për jo më shumë se tre pozicione të lira ose pozicione që priten të bëhen të lira. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se një pozicion, ai bën renditjen e tyre sipas preferencës*”.

11. Pas publikimit të vendimeve, afatet e kandidimit kanë filluar të ecin nga dita e nesërme, pra nga data 29.02.2020.

12. Afatet e kandidimit për procedurat e mësipërme të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë u pezulluan nga Këshilli më datë 12.03.2020, për shkak të situatës së krijuar në vend nga përhapja e Covid-19. Ndërkohë, me Vendimin e Këshillit nr. 142, datë 22.04.2020, afatet e kandidimit për tre procedurat e para të ngritjes në detyrë u zgjatën edhe për një periudhë tjetër të caktuar. Konkretisht, për dy pozicionet e para të lira, në secilën nga dy fushat e së drejtës, afati i kandidimit u zgjat me një javë, duke përfunduar ai më datë 29.04.2020. Për dy pozicionet e dyta të lira, në secilën nga dy fushat e së drejtës, afati i kandidimit u zgjat me një muaj, duke përfunduar ai më datë 26.05.2020. Ndërsa për dy pozicionet e treta të lira, në secilën nga dy fushat e së drejtës, afati i kandidimit nuk u zgjat dhe ai përfundon më datë 30.07.2020.

II. KANDIDIMET E Z. {...}

13. Më datë 09.03.2020, z. {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, depozitoi pranë Këshillit dy kërkesa me shkrim përmes të cilave ka shprehur interesin për të kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë:

- a) për pozicionin në fushën e të drejtës administrative;
- b) për pozicionin në fushën e të drejtës civile.

14. Në të dyja kërkesat sipas pikës 13 të këtij vendimi, z. {...} nuk ka identifikuar procedurat e ngritjes në detyrë në të cilat kandidonte nëpërmjet numrave të vendimeve të Këshillit me të cilët ato ishin shpallur/hapur. Po ashtu, në secilën nga këto kërkesa, z. {...} është shprehur edhe se

“... në zbatim të §1, të nenit 48 të ligjit n.96/2016, sepse kam kandiduar për të dy pozicionet e lira, renditjen e tyre e bëj sipas renditjes së shqyrtimit që bën Këshilli i Lartë Gjyqësor. ...”

15. Më datë 18.05.2020, z. {...} depozitoi pranë Këshillit edhe katër kërkesa të tjera përmes të cilave ka shprehur interesin për të kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë:

- a) për pozicionin në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin nr. 83, datë 26.02.2020;
- b) për pozicionin në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin nr. 84, datë 26.02.2020;
- c) për pozicionin në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020;
- ç) për pozicionin në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 87, datë 26.02.2020.

III. SHQYRTIMI I KANDIDIMEVE TË Z. {...}

16. Kërkesat e z. {...}, të datës 09.03.2020, nëpërmjet të cilave ka kandiduar për ngritjen në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, pavarësisht mosidentifikimit të procedurave të ngritjes në detyrë sipas numrave të vendimeve të Këshillit, ndërsa ishin paraqitur brenda afatit të kandidimit për dy pozicionet e para të lira në secilën nga dy fushat e së drejtës, pra për ato të shpallura me Vendimet nr. 82 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, Këshilli i pranoi këto kandidime, ndërsa me Vendimin nr. 151, datë 06.05.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr. 82, datë 26.02.2020 dhe Vendimin nr. 85, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, ka vendosur:

“I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr.82, datë 26.02.2020 (në fushën e të drejtës administrative) dhe me Vendimin nr.85, datë 26.02.2020 (në fushën e të drejtës civile), të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: 4. Për kandidatin z. {...} - relator znj. Marçela Shehu;... ”.

17. Ndërkohë, në kushtet kur në secilën nga kërkesat për shprehje interesi të datës 09.03.2020, z. {...} shprehej se kishte kandiduar për dy pozicione të lira, atëherë, sipas një interpretimi, rezultonte që ai të kishte kandiduar për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative dhe për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, pra në total për katër pozicione të lira të shpallura në të njëjtën kohë (më datë 26.02.2020). Pikërisht nisur nga kjo, patur parasysh se pika 6, e nenit 48, të Ligjit për Statusin, kufizon të drejtën e kandidimit për ngritjen në detyrë deri në tre pozicione të lira apo që priten të bëhen të lira, ndërkohë që aplikimet e z. {...} ishin konsideruar për dy procedurat e para të ngritjes në detyrë, pra për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 82 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës konsideroi t’ a ftojë atë për të përcaktuar pozicionin e tretë të lirë për të cilin kandidonte.

18. Në këtë rast, në vlerësimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, ligji, pikërisht fjalia e parë, e pikës 6, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, përcaktonte qartësisht një maksimum prej tre pozicionesh, jo gjykatash, për kandidim për ngritjen në detyrë. Pra, në rastin e hapjes në të njëjtën kohë të disa procedurave për ngritjen në detyrë, një kandidat, në total, mund të aplikonte për ngritjen në detyrë për jo më shumë se tre pozicione të lira ose që priten të bëhen të lira, qofshin këto pozicione në të njëjtën gjykatë apo në gjykata të ndryshme ose në të njëjtën fushë të së drejtës apo në fusha të ndryshme të saj.

19. Konkretisht, z. {...}, u njoftua nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, me e-mailin e datës 11.05.2020, për të përcaktuar pozicionin e tretë për të cilin kandidonte për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë.

20. Në përgjigje të kësaj ftese të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, me e-mailin e datës 12.05.2020, z. {...} u përgjigj se ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë vetëm për një pozicion të lirë dhe jo për disa të tillë. Konkretisht, ai parashtrroi se:

“Sipas nenit 47 të ligjit n.96/2016, i cili përcakton kriteret minimal për ngritjen në detyrë: «ngritja në detyrë është kalimi nga: një pozicion në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në një pozicion tjetër të një niveli më të lartë”. Për të bërë një shembull, gjyqtari mund të kandidojë për ‘një pozicion’ në gjykatën e Apelit të zakonshëm, mund të kandidojë për ‘një pozicion’ në Gjykatën për korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe mund të kandidojë për ‘një pozicion’ në Gjykatën e Lartë’, duke qenë kështu në përputhje me parashikimin se “[...] kandidati mund të kandidojë për jo më shumë se tre pozicione të lira [...]” (§6, neni 48, ligji n.96/2016). Vetëm nëse kandidati përveçse për tre ‘pozicionet’ e mësipërme, kandidon për një apo më shumë pozicione të tjera, për shembull për ‘një pozicion’ në Gjykatën e Apelit për korrupsionin dhe krimin e organizuar, duke u bërë kandidimi për më shumë se tre ‘pozicione’, nuk ka respektuar këtë ndalim.

Nga kjo përfitohet dija se ‘pozicion’ - për rastin e kandidimit tim - është kalimi nga një gjykatë – në të Apelit që jam unë - në një gjykatë të një niveli më të lartë si ajo e Gjykatës së Lartë, për të cilën unë kandidoj.

Në të kundërt, nga kjo është e qartë se nuk është ‘pozicion i ndryshëm’ nga ai i kandidimit në Gjykatën e Lartë, Shpallja e Këshillit të Lartë Gjyqësor ‘për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative’ (vendimi n.82, dt.26/02/2020 i KLGj); “për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës administrative” (vendimi n.83, dt.26/02/2020); “për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës administrative” (vendimi n.84, dt.26/02/2020); “për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile” (vendimi n.85, dt.26/02/2020); “për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile” (vendimi n.86, dt.26/02/2020); “për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile” (vendimi n.87, dt.26/02/2020); për secilin vend të lirë të shpallur për këtë gjykatë, sepse ‘ngritja në detyrë është kalimi nga një pozicion tjetër të një niveli më të lartë. Nuk mund të konsiderohet ‘fusha e një të drejte’ e së njëjtës gjykatë ‘pozicion’ i ndryshëm. Pozicion konsiderohet pozicioni në një Gjykatës si gjykatës i saj dhe jo ai në seksione për fusha të ndryshme të së drejtës.

Në këtë rast kandidimi mbetet një, për një pozicion në Gjykatën e Lartë, për secilin ‘Njoftim – Për shpalljen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë n.82, n.83, n.84, n.85, n.86, n.87 të KLGj datë 26/02/2020, pamvarsisht se në mënyrë djallzore nëpërmjet konfondimit të termit ‘ngritje në detyrë’ me termin ‘pozicionin’ dhe shoqëruar me përcaktimin e afateve të ndryshme për secilin njoftim, bëhen përpjekje të pengohet kandidimi për secilin prej tyre.

Përcaktimi i ‘fushës së të drejtës civile apo administrative’ në Gjykatën e Lartë, nuk bën që të konsiderohet secili nga ato një ‘pozicion’ i veçantë dhe për këtë të përbëjë pengesë parashikimi se “[...] kandidati mund të kandidojë për jo më shumë se tre pozicione të lira [...]” (§6, neni 48, ligji n.96/2016).

Rrjedhimisht kandidimi im që është ai i ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, pra ‘kalimi nga pozicioni në sistemin gjyqësor që mbaj në Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në pozicionin tjetër të një niveli më të lartë të Gjykatës së Lartë’, sipas kuptimit të gërmës ‘a’ të §1, të nenit 47 të ligjit n.96/2016, në të gjashtë rastet e njoftimit n.82, n.83, n.84, n.85, n.86, dhe n.87, datë 26/02/2020 të KLGj, është kandidimi për ‘një pozicion’ në Gjykatën e Lartë’ dhe jo për ‘disa pozicione’ në Gjykatën e Lartë’.

Rrjedhimisht interpretimi konfondues i 'pozicionit' me 'rastet e kandidimit' për të njëjtin pozicion në Gjykatën e Lartë, përveçse është 'dashakeqës' dhe bie ndesh me parimet e konkurimit, është një interpretim në kundërshtim me ligjin dhe si i tillë i rrëzueshëm në Gjykatë."

21. Pas kësaj përgjigje, si dhe më lart u parashtrua, më datë 18.05.2020, z. {...} depozitoi pranë Këshillit katër kërkesa për shprehje interesi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, duke identifikuar dhe pozicionet e lira sipas numrave të vendimeve të Këshillit me të cilët janë hapur procedurat e ngritjes në detyrë në këto pozicione, pikërisht sipas Vendimeve nr. 83, nr. 84, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020.

22. Më datë 26.05.2020 përfundoi afati i kandidimit për dy pozicionet e dyta të lira në secilën nga dy fushat e së drejtës, pra për ato të shpallura sipas Vendimeve të Këshillit nr. 83 dhe nr. 86, datë 26.02.2020. Për këto procedura ngritjeje në detyrë duhet të fillonin procedurat e verifikimit të kandidatëve, gjë për të cilën Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozoi Këshillit Projektvendimin "Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr. 83, datë 26.02.2020 dhe Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor". Gjatë shqyrtimit të këtij projektvendimi, pasi konstatoi se kandidati z. {...} kishte kandiduar për ngritjen në detyrë në më shumë se tre pozicione të lira, në fakt për gjashtë pozicione të lira, ku për dy nga të cilat kandidimet ishin pranuar, Këshilli, në mbledhjen e datës 04.06.2020, duke konsideruar se ligji, pika 6, e nenit 48, të Ligjit për Statusin kufizonte të drejtën e kandidimit për ngritjen në detyrë për jo më shumë se tre pozicione të lira apo që pritej të bëheshin të lira, vendosi që z. {...} të ftohej përsëri për të përcaktuar pozicionin e tretë të lirë për të cilin kandidonte, pra njërin nga pozicionet e shpallura me Vendimet e tij nr. 83, nr. 84, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020.

23. Në përgjigje të ftesës së Këshillit, me e-mailin e datës 05.06.2020, z. {...} dërgoi të njëjtën përgjigje sikundër dhe ajo për Komisionin e Zhvillimit të Karrierës të parashtruar më lart, thelbi i të cilës konsistonte se kishte kandiduar gjashtë herë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë vetëm për një pozicion të lirë.

IV. VLERËSIMI I KANDIDIMEVE TË Z. {...}

24. Pranueshmëria e katër kandidimeve të z. {...} u shqyrtua nga Këshilli në mbledhjen e datës 11.06.2020, në kuadër të përfundimit të shqyrtimit të Projektvendimit "Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr. 83, datë 26.02.2020 dhe Vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor".

25. Edhe në këtë rast, sikurse kishte vlerësuar edhe më parë, Këshilli konsideroi se pika 6, e nenit 48, të Ligjit për Statusin, në mënyrë të qartë kufizon të drejtën e kandidimit për ngritjen në detyrë deri në tre pozicione të lira apo që priten të bëhen të lira, qofshin këto pozicione në të njëjtën gjykatë apo edhe në të njëjtën fushë të së drejtës.

26. Lidhur me këtë, Këshilli vlerësoi se neni 48 i Ligjit për Statusin përcakton se pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë, por jo vetëm, plotësohen nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë (pika 1), ndërkohë që për çdo pozicion të lirë organizohet një procedurë ngritjeje në detyrë (pika 2), ndërsa secila procedurë shpallet/hapet (pika 3) dhe finalizohet me përzgjedhjen e kandidatit të renditur më lart apo me pikët më të larta (pika 10, 11 dhe 12). Pra, ligji përcakton qartësisht organizimin e një procedure të pavarur ngritjeje në detyrë për çdo pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë, por jo vetëm, ku në rastin e disa pozicioneve të lira organizohen aq procedura sa këto pozicione janë. "Pozicion i lirë" në Gjykatën e Lartë në kuptim të nenit 48 të Ligjit për Statusin,

është ai pozicion kur gjyqtari që e ka patur atë për një mandat 9-vjeçar, i ka përfunduar ky mandat ose atij i ka mbaruar statusi i magjistratit¹ për shkak që përcakton pika 1, e nenit 139, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sikundër edhe nenet 64 e vijues të Ligjit për Statusin. Çdo procedurë ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Lartë, por jo vetëm, identifikohet me numrin e vendimit të Këshillit që shpall/hap atë procedurë, ndërsa pozicioni i lirë identifikohet sipas fushës së të drejtës përkatëse të përshtatshme për atë pozicion, identifikim ky që lidhet drejtpërdrejtë me përvojën profesionale të kandidatit, që përbën një nga kriteret e ngritjes në detyrë sipas pikës 5, të nenit 47, të Ligjit për Statusin, sikundër dhe një nga kriteret e renditjes së kandidatëve sipas shkronjës “b”, pika 9, të nenit 48, të këtij ligji. Sa i përket fushave të së drejtës për pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë ato rezultojnë nga organizimi i kësaj gjykate në kolegje sipas tre fushave të së drejtës, referuar për këtë në pikën 1, të nenit 31, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, që përcakton se: “Gjykata e Lartë organizohet në Kolegjin Civil, Kolegjin Penal dhe Kolegjin Administrativ”.

27. Këshilli çmon të theksojë se sipas nenit 47, pika 1, të Ligjit për Statusin, ngritja në detyrë e gjyqtarit është kalimi nga një pozicion në një gjykatë në një pozicion tjetër të një gjykate të një niveli më të lartë dhe konkretisht në Gjykatën e Lartë, në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar ose në gjykatat e apelit. Termi “pozicion” në këtë dispozitë nuk nënkupton që gjykata më e lartë ka vetëm një pozicion apo se të gjithë pozicionet e kësaj gjykate, në kuadër të ngritjes në detyrë, nënkuptojnë një pozicion të vetëm. Në këtë rast ligjvënësi ka përcaktuar kuptimin e “ngritjes në detyrë”, pra se një gjyqtar mund të ngrihet në detyrë në një pozicion në një gjykatë më të lartë. Sipas Ligjit për Statusin, çdo gjyqtar caktohet në një pozicion në një gjykatë, pra çdo gjyqtar ka pozicionin e vetë në sistemin gjyqësor. Çka do të thotë se edhe në rastin e ngritjes në detyrë, gjyqtari caktohet në një pozicion në një gjykatë të një niveli më të lartë. Nga ana tjetër, ngritja në detyrë e gjyqtarit mund të ndodhë vetëm përmes kandidimit jo për çdo pozicion në gjykatën më të lartë, por vetëm për një pozicion të lirë, për të cilin shpallet procedura përkatëse e ngritjes në detyrë, duke u identifikuar ky pozicion sipas fushës përkatëse të së drejtës të përshtatshme për të. Thënë sa më lart, koncepti i “ngritjes në detyrë” nuk është i barasvlerëshëm me atë të “kandidimit”. Synimi i gjyqtarit për t’u caktuar (ngritur në detyrë) në një pozicion në një gjykatë më të lartë, nuk nënkupton që kandidimet e tij për disa pozicione të lira në këtë gjykatë janë një kandidim i vetëm apo që këto pozicione janë vetëm një pozicion.

28. Nga sa më lart, në rrethanat kur z. {...} ka kandiduar njëherazi për më shumë se tre pozicione të lira, në realitet për gjashtë të tilla, ndërsa më herët janë pranuar kandidimet e tij për dy pozicionet e para të lira, ato të shpallura me Vendimet nr. 83 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, në kushtet kur nga ana e tij, megjithëse iu kërkua në mënyrë të përsëritur, nuk pati një përgjigje të qartë për pozicionin e tretë të lirë për të cilin kandidonte, por që gjithësesi konsideroi edhe pozicionin e lirë që i korrespondon procedurës së ngritjes në detyrë të hapur me Vendimin nr.83, datë 26.02.2020, Këshilli vlerësoi se pozicioni i tretë për të cilin ka aplikuar kandidati z. {...} të konsiderohet pikërisht ai që është shpallur me këtë vendim. Për këtë, Këshilli mbajti parasysh se kandidimi për këtë pozicion të lirë është i pari në radhë në raport me kandidimet e mëpasme për tre pozicionet e tjera të procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, të hapura me Vendimet nr.84, nr.86 dhe nr.87, datë 26.02.2020.

29. Në rrjedhje të kësaj, në lidhje me fillimin e procedurave të verifikimit të kandidatëve për pozicionet e dyta të lira në secilën nga dy fushat e të drejtës, Këshilli e përfshiu z. {...} në listen e kandidatëve për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 83, datë 26.02.2020.

¹ Për shkak të: dorëheqjes; vërtetimit të kushteve të pazgjedhshmërisë ose të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; mbushjes së moshës së pensionit; shkarkimit nga funksioni për përgjegjësi disiplinore; vërtetimit të faktit të pamundësisë për të ushtruar detyrën.

30. Nga ana tjetër, përcaktimi në këtë mënyrë të pozicionit të tretë të lirë për të cilin ka kandiduar z. {...}, bën të papranueshme kandidimet e tij për pozicionet e tjera të lira, pra për ato të shpallura me Vendimet nr.84, nr.86 dhe nr.87, datë 26.02.2020, për të cilat, në kushtet e kandidimit në shkelje të ndalimit të ligjit, Këshilli vlerësoi që ai të mos përfshihet në listat e kandidatëve.

V. KONKLuzioni

31. Nga sa rezulton, Këshilli vlerëson se, në zbatim të pikës 6, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, për z. {...} duhet të vendoset mospërfshirja në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e tij nr. 84, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tre pozicione të lira të shpallura në të njëjtën kohë.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenet 85 dhe 86, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe pikën 6, të neni 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Mospërfshirjen e aplikuesit z. {...} në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 84, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tre pozicione të lira të shpallura në të njëjtën kohë.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
3. Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR